

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Krimeve të Rënda, gjyqtari Nikollë Komani, kryetar i trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. M. nga Gjakova, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së dhe kundër të akuzuarit A. I nga Gjakova, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I nr. 9/2017 të datës 28.04.2017, në shyrtime fillestar me datë **30.06.2017**, në prezencën e prokurorit Ali Uka, të akuzuarve A. M. dhe A. I., më datë **03.07.2017**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. M.**, i biri i I. dhe F., e gjinisë T., data lindjes..., në Gjakovë, me banim në rrugën “A. M.” i gjendjes së varfër ekonomike, punëtor, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuari **A. I.**, i biri i H. dhe L., e gjinisë M., data e lindjes..., në fshatin B. B. Komuna Gjakovë, me banim në rr. “S.” i pa martuar, kamerier, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak nga data 07.02.2017 deri me datë 06.03.2017.

I akuzuari **A. M.**

ËSHTË FAJTOR

Sepse pa autorizim ka poseduar substancë narkotike në atë mënyrë që ditën kritike me datë 07.02.2017, rreth orës 14,20 minuta në vendin e quajtur “Qarshia e Vjetër” në Gjakovë, nga ana e njësitit operativ të drejtorisë regjionale për antidrogë DHTN në Gjakovë, është ndaluar i pandehuri A., ashtu që pas kontrollit të bërë të tij, në xhepin e tij të majtë të pantallonave kanë gjetur dhe sekuestruar substancë narkotike e që sipas raportit mbi ekzaminimin e saj me numër AKF/2017-0515/2017-464 ka dalur të jetë e llojit “Marihuan” me peshë prej 1.56 gram.

- **me çka ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 275 par. 2/1 të KPRK-së.**

I akuzuari **ARGNIS IBRAHIMI**

ËSHTË FAJTOR

Sepse pa autorizim ka poseduar substancë narkotike me qëllim të shitjes, në atë mënyrë që ditën kritike me datë 07.02.2017, Drejtoria Rajonale e Policisë-Antidroga në Gjakovë, në bazë të një urdhri verbal të prokurorit e të konfirmuar nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake në Gjakovë, ka bërë

kontrollin dhe bastisjen e shtëpisë dhe lokaleve tjera përcjellëse të pandehurit A. në Gjakovë, rr."S." me ç' rast në kuzhinën e shtëpisë kanë gjetur dhe sekuestruar substancë narkotike që sipas raportit mbi ekzaminimin e saj me numër AKF/2017-0515/2017 ka dalur të jetë e llojit "Marihuanë" me peshë prej 141,35 gram.

- **me çka ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së.**

Gjykata në bazë të nenit 6, 7, 17, 41, 43, 46, 49, 50, 51, 52 par. 2, 73, 74, 75, 275 par. 2/ 1, 273 par. 1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, i:

G J Y K O N

Të akuzuarin **A. M.** dënim me gjobë në shumën prej **600,00 €** (gjashtëqind euro), të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në afatin prej 1 (një) muaj nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë ditëve) duke ia llogaritur 20,00 € për një ditë burgimi.

Të akuzuarin **A. I.** dënim me gjobë në shumën prej **1200,00 €** (njëmijë e dyqind euro) të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në dy këste në afatin prej 2 (dy) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë kësti i parë në shumën prej **600,00 €** (gjashtëqind euro) do të paguhet deri me datën 05, të muajit të parë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe kësti i dytë në shumën prej **600,00 €** (gjashtëqind euro) do të paguhet deri me datën 05, të muajit të dytë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, si dhe **Dënim** me burgim në kohë zgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 3 (tri) viteve nuk kryen vepër tjetër penale, e në të cilin dënim në rast të revokimit të kushtit do ti llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak dhe atë nga data 07.02.2017 deri me atë 06.03.2017.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë ditëve) duke ia llogaritur 20,00 € për një ditë burgimi.

Detyrohen të akuzuarit që secili veç e veç ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej **60,00 €** në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konfiskohen substancat narkotike të llojit marihuan në sasi prej 1.56 gram dhe 141,35 gram, si objekte të kryerjes së këtyre veprave penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP/I nr. 9/2017 të datës 28.04.2017 ka akuzuar A. M. nga Gjakova, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së dhe kundër të akuzuarit A. I. nga Gjakova, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par. 1 të KPRK-së.

Prokurori **Ali Uka** pas leximit të aktakuzës ka bërë përmirësimin e kualifikimit juridik të veprës penale për të akuzuarin A. M. duke theksuar se në vend të paragrafit 3 duhet të jetë vepra penale nga neni 275 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, pasi që janë më pakë se 3 gram dhe pasi dy të akuzuarit kanë pranuar në tërësi fajësinë ka theksuar se pranimit i fajësisë është bërë me vullnet, pa presion, të njëjtit i kanë kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimit i fajësisë ka mbështetje në provat e siguruar gjatë procedurës së hetimeve e të propozuar në aktakuzë, ashtu që i propozon gjykatës që këtë pranim të fajësisë së bërë nga ana e të akuzuarve A. M. dhe A. I. ta aprovoi.

I akuzuari **A. M.** duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se e pranon në tërësi fajësinë, pendohet dhe premtion se asnjëherë tjetër nuk ka kryen kësi vepra penale.

I akuzuari **A. I.** ka deklaruar se e pranon në tërësi fajësinë, pendohet për veprën e kryer dhe premtion se më nuk do të kryen vepra penale dhe i propozon gjykatës që të ja jep një mundësi pasi që është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe tani ka kuptuar se ka kryer vepër të dëmshme dhe se premtion se më nuk do të kryen vepra penale.

Pasi që Gjykata ka fituar bindjen se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale që ju vihen në barrë dhe është bindur se pranimitin e fajësisë e kanë bërë në baza vullnetare, ka konstatuar se pranimitin i fajësisë ka mbështetje në provat që i përmban aktakuza si raporti i ekspertimit i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë AKF/2017-0515/2017-464 e datës 27.04.2017, procesverbali mbi bastisjen e banesave dhe personave e datës 07.02.2017, raportet e oficerit të datës 07.02.2017, dëftesa mbi konfiskimin e pronës e datës 07.03.2017, foto-albumi ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par. 4 të KPP-së, ka bërë pranimitin e fajësisë së bërë nga të akuzuarit A. M. dhe A. I. dhe shqyrtimin fillestar e ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të paraparë me nenin 73 të KPP-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë rënduese për të akuzuarin A. M. ka marrë parasysh faktin se i njëjti ka qenë i dënuar për vepra penale të natyrës së njëjtë dhe atë në lëndën penale P. nr. 423/09 dënim me gjobë në shumën prej 400,00 € dhe lëndën penale P. nr. 119/15 dënim me gjobë në shumën prej 300,00 €, ndërsa për të akuzuarin A. I. përpos konstatimit të kryerjes së kësaj vepre penale në mënyrën, kohën dhe vendin si në dispozitivin e II-të, të këtij aktgjykimi nuk ka gjetur rrethanë rënduese. Ndërsa si rrethana lehtësuese për dy të akuzuarit ka marrë parasysh pranimitin e fajësisë, pendimitin e tyre, kërkim faljen dhe premtimin se nuk do të kryej vepra tjera penale, e për të akuzuarin A. I. ka marrë parasysh edhe faktin se asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin dhe nuk zhvillohet asnjë procedurë tjetër penale, e të cilat rrethana lehtësuese kanë ndikuar që gjykata për këtë të akuzuar ti aplikoi dispozitat e zbutjes së dënimit bazuar në nenin 52 par. 2, 74 dhe 75 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarit A. M. ja ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumën prej 600,00 €, ndërsa të akuzuarit A. I. e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumën prej 1200,00 €, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 3 (tri) viteve nuk kryen vepër tjetër penale, e në të cilin dënim në rast të revokimit të kushtit do ti llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 07.02.2017 deri me datë 06.03.2017, me bindjen e plotë se këto dënime janë në harmoni me peshën e veprave penale, shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarve dhe se gjykata është e bindur se me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskimin e substancave narkotike e llojit marihuan në sasi prej 1.56 gram dhe 141,35 gram, është marrë bazuar në nenin 273 par. 5 dhe 275 par. 3 të KPP-së.

Vendimi për shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
PKR. nr. 49/17 datë 03.07.2017

Sekretarja Juridike
Mandushe Doli

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Nikollë Komani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes të kësaj gjykate.